



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR 5 DHE 6 SHTATOR 2018**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 5. I 6. SEPTEMBRA 2018. GODINE**

**SHTATOR - SEPTEMBAR
2018**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korigjim të kufijve” në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Dnevni red

1. Parlamentarna debata u vezi angazhovanja Predsednika Kosova u uključivanju “razmene teritorija” ili “korigovanja granica” u dijalogu između Kosova i Srbije

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi duke qëndruar në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, para publikut. A dëshironi pauzë, a dëshironi... për arsye se jeni vetëm duke qëndruar dhe asnjë vendimmarrje nuk ka.

Aktualisht janë 59, 58 deputetë, duhet të jenë 61 nga ju në sallë, në mënyrë që të fillojë seanca. 61 deputetë, prandaj nuk kemi nevojë t'i maltretojmë as qytetarët, as veten. Unë jam i hapur në option. Dëshironi... si të dëshironi, seancën nuk jam duke e mbyllur, sa për paralajmërim.

Sa të keni dëshirë e mbaj të hapur. Seanca nuk është e hapur, nuk mund të flasë askush, as propozuesi, për arsye se nuk e kemi hapur seancën. Jemi në fazën e hapjes, prandaj duhet t'i japim një përgjigje kësaj situatë. E mira do të ishte ta kishim pasur një seancë të përbashkët. Mund ta thërras mbledhjen e Kryesisë, nëse dëshironi, por çështja është e konsultimit. Kryetarët e grupeve parlamentare le të ma japin një adresim. Dëshironi pauzë, shkojmë pauzë; i dëshironi dy orë, shkojmë dy orë; dëshironi të shkojmë në mbledhjen e Kryesisë, që është edhe propozimi im, shkojmë në mbledhjen e Kryesisë, për arsye se i kemi dy iniciativa.

Ka kaluar gjysmë ore nga fillimi i seancës. Edhe në seancën e parë të jashtëzakonshme njëjtë kemi lëvizur pastaj në momentin kur s'ka pasur votim. Po dua të jem korrekt në qëndrimin tim tani si kryesues i kësaj seance.

Shkojmë në pauzë! Kur të bëheni gati, unë jam në zyrën time. Pra, kur të bëheni gati, jam në zyrë. Në momentin që mendoni ta vazhdojmë seancën vetëm më thërrisni, jam në zyrën e kryetarit të Kuvendit. Urdhëroni, në pauzë jemi. Pauza është permanente deri në gjysmë të natës, deri në mëngjes, kur të bëheni gati unë jam në zyrë, prapë vij, ju bashkëngjitem dhe vazhdojmë. Nuk ka të drejtë, se nuk është hapur seanca. Arben, në rastin tjetër u tregon si kujdestar i Rregullores që je për mua, që s'ka të drejtë.

Ndërkohë, ju lutem, ishte edhe nënkryetar i Kuvendit, i cili kërkon 30 minuta pauzë. 30 minuta do të kemi pauzë. Pas 30 minutave do të vij prapë në sallën e Kuvendit dhe ju si kolegë deputetë. 30 minuta, pra do të thotë në 20:35.

* * *

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I kisha lutur shefat e grupeve parlamentare që ta kenë një konsultim, të paktën e dinë saktësisht si e kanë situatën, për arsye se po shoh edhe moskoordinim ndërmjet grupeve parlamentare. Ta dimë se cili është drejtimi i kësaj seance. Një informacion... Urdhëroni, konsultohuni... Për fjalë,

me respektin e madh, nuk kam të drejtë t'jua jap, se gjithë ditën ju kisha lënë të flisni, por e keni mundësinë, gazetarët janë të gjithë jashtë dhe janë duke pritur konferencat për shtyp.

Po, sido që të jetë, ne po flasim për seancë, se s'kam mundur ta hap seancën, sepse s'janë 61 deputetë. Kjo është arsyeja, të jem më i qartë për publikun. Çështja është se s'po mund të futemi në seancë fare. Çështja e dytë është se grupet parlamentare, kur po e pyes njërin, thotë unë i kam kaq deputetë... Koordinohuni ndërmjet vete, ju e dini saktë sa deputetë i keni. Ka edhe një qëndrim politik shumë të qartë nga partnerët e koalicionit, që u është dhënë një mundësi. Kisha lutur, mundësisht, na jepni një qartësim.

Tash edhe një herë, dëshironi ende kohë? Në 24:00 të natës, vetëm më jepni një mundësi. Në 24:00 të natës, në dy të mëngjesit, në gjashtë të mëngjesit... ama pa përgjigje nuk mund ta mbajmë seancën hapur.

Për hir edhe të informimit të opinionit publik, seanca e kaluar ka pasur kuorum, është futur me 63 deputetë. Nuk ka pasur kuorum në votim. Kjo ka qenë arsyeja e kësaj zgjatjeje që ka ndodhur dje dhe sot. Interpretimet politike janë çështje që e bëjnë partitë politike, por kjo është arsyeja. Më tepër për qytetarë, se ne si deputetë këtu e dimë shumë mirë, por është konsumi politik, është në fund të fundit legjitimitet, kushdo çfarë të dojë të flasë.

A ka mundësi një koordinim? A dëshironi në orën 24 të natës, dëshironi në orën dy të mëngjesit, dëshironi pas një ore...? Vetëm më tregoni kur. Ju kisha lutur të afroheni te foltorja. Jo, në foltoje nuk kam të drejtë t'jua jap fjalën.

Kështu: nënkryetari i Kuvendit kërkoi që nesër në orën 10:00, në emër të të gjithë juve. Përgjegjësia publike nuk është e imja. Unë nuk po e përcaktoj nesër në orën 10:00. Është kërkesa e juaj. Jeni me 51 nënshkrime. Unë e bart për nesër në orën 10:00. Vetëm kisha pasur dëshirë që nesër, ju lutem, të mos ripërsëritet e njëjta situatë, jo për mua, për hir të qytetarëve. Më mirë ka qenë të thirret një Kryesi, e të bëhemi të gjithë bashkë, në një seancë të përbashkët. Faleminderit!

Atëherë nesër në orën 10:00. Kjo është vendimmarrja.

* * *

E enjte, 6 shtator 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 shtator 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi në vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme, të kërkuar nga 51 deputetë nënshkrues. Kemi mbetur në situatën e mungesës së kuorumit për ta hapur këtë seancë, aktualisht janë 54 deputetë, në fakt. I kisha lutur kolegët deputetë... tani me mua 56.

Nuk është korrekte të mbahet kjo situatë, të cilën e kemi aktualisht. Në foltore do të jem sa më i kufizuar, vetëm si kryesues. Shumë simpatikë jeni!

Në këto rrethana kisha pasur dëshirë që kryetarët e grupeve parlamentare, të jemi shumë seriozë, ta merrni një drejtim. E keni edhe një qëndrimin të qartë, në qoftë se arrini t'i bëni 58 deputetë, vijnë votojnë edhe deputetët e pozitës, Naiti është duke prituri në një këmbë, edhe unë jam këtu prej Partisë Demokratike të Kosovës, nga Nisma të gjithë vijnë, kur t'i bëni 58.

Në këto rrethana, unë kisha kërkuar, është në interesin tuaj, është në interesin e vendit, të mos e bojkotojmë njëri-tjetrin. Të ulemi bashkërisht, krijoni mundësi të flitet në debat për mbrojtjen e Kosovës, se lodheni nëse e mbroni vetëm ju. Ta mbrojmë bashkë dhe të dalim në ballafaqim të përbashkët. Nxjerrim rezolutë, krijojmë platformën nga ky Kuvend, i obligojmë institucionet që të ketë përfaqësim. Në të njëjtën kohë krijohet edhe Grupi i Unitetit.

Edhe pesë minuta po pres, në qoftë se nuk arrini, po e shoh se aktualisht në sallë janë 56 deputetë, pastaj dal te vendimmarrja, se s'mund ta hap seancën. Edhe dje, në fakt, e kemi pasur të njëjtën situatë.

Duhet të dal te vendimmarrja dhe ju jeni përgjegjës për vendimmarrjen time. Tani 57. E lus regjinë t'i bjerë ziles. Ju lutem! Dje e kemi shtyrë seancën pikërisht për mungesë të kuorumit, e kemi një situatë analoge, të njëjtë sot. Megjithatë, po presim deri në 10:45. Jemi 57, një vërejtje me vend, përfshirë edhe mua, 57 jemi aktualisht në sallë, ta kini parasysh. 57 jemi në sallë.

* * *

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Kemi një situatë reale për dy ditë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në këto rrethana jam i detyruar që ta mbyll këtë seancë dhe në orën 14:00 e kisha ftuar Kryesinë e Kuvendit, së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare. Për sot, në orën 14:00, e ftoj Kryesinë e Kuvendit së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare në mbledhje të përbashkët. Ju falënderoj për mirëkuptim. Faleminderit!

* * *

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*